



**Prishtinë: 14.01.2008**  
**Kodi i ZRRë-së: D\_084\_2008**  
**Nr. i Referencës: ERO/CPD\_R\_63\_12\_2007**

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dispozitat sipas Rregullit mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
4. Ligjin Nr. 02/L-47 për Radio Televizionin e Kosovës.
5. Ankesën e konsumatorit në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRë me datë 19.09.2007 e numër regjistrimi 116/09 2007;
6. Procesin e pranimit të instalimit të njehsorit të datës 26.04.2005;
7. Procesverbalin nr. 003026 të datës 04.09.2007
8. Përgjigjen e KEK Sh.A me numër të referencës DPR – CO1 – 12;
9. Përgjigjen e KEK Sh.A me numër të referencës DPR – CO1 – 01;
10. Njoftimin për shkycje të datës 18.08.2007;
11. Urdhëresa për shkycje e datës 03.10.2006;
12. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë

**Në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2008 morri këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Qerim Ademi, Kop. Bujqësore “TEUTA” (konsumator komercial – 7/02, shifra e konsumatorit DPR - 90039267), për arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

1. Konsumatori në kërkesën e tij ka kërkuar që të hiqet gjoba për shkycje, njoftimi për shkycje si dhe taksa për emetuesin publik (RTK).
2. KEK Sh.A iu është përgjigjur konsumatorit lidhur me ankesën e konsumatorit të datës 10.10.2006, ku në përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë refuzohet konsumatori në arsyetimin se në bazë të urdhëresës administrative “*çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër në Kosovë është i obliguar sipas ligjit që ta paguajë PEP (pagimi i emitimit publik – RTK).*”
3. KEK Sh.A iu është përgjigjur konsumatorit lidhur me ankesën e konsumatorit të datës 22.01.2007, ku në përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë refuzohet në arsyetimin se: “*ky konsumator është shkycur nga rrjeti*

*me datë 03.10.2006 për shkak të borxhit të cilin nuk e ka likuiduar me data të ndryshme të obligimit për pëlqimin elektroenergjetik dhe për taksat mujore të emetimit publik gjithashtu edhe për harxhimin e energjisë elektrike të faturuar. Në përgjigjen e KEK Sh.A Poashtu ceket se në bazë të urdhëresës administrative të UNMIK-ut 2003/12 “çdo shtëpi, biznes, ndërmarje apo institucion tjetër në Kosovë është i obliguar sipas ligjit që ta paguajë PEP (pagimin e emetimit publik). Dhe në fund të përgjigjes së KEK Sh.A ceket se fatura e parë është shërbimi i regjistrimit të njehsorit”.*

4. Konsumatori iu ka drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRë lidhur me një ankesë ku konsumatori konteston njoftimin për shkyçje, shkyçjen dhe parapagimin për RTK ku në kërkesën e tij kërkon që ti hiqen gjobat për shkyçje dhe taksa për emetuesin publik (RTK).
5. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRë gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë të dokumentacioneve të ofruara nga KEK Sh.A dhe nga konsumatori, ka propozuar Bordit të ZRRë-së që të refuzojë ankesën e konsumatorit me nr. 116/10 2007 për arsye si në vazhdim:
  - 5.1 Me datë 18.08.2006 KEK Sh.A e ka njoftuar konsumatorin me anë të Njoftimit për Shkyçje për borxhin që konsumatori ka ndaj KEK Sh.A, sipas nenit 16.1. a) të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ishte 214.15 €. Njoftimi për shkyçje e ka ngarkuar konsumatorin në shumë prej 10.00 € plus TVSH, pra e gjitha prej 11.50 €.
  - 5.2 Me datë 03.10.2006 për shkak se konsumatori nuk i ka përmbush të gjitha specifikacionet e paraqitura në njoftimin për shkyçje, ekipi i autorizuar i KEK Sh.A me anë të Urdhëresës për Shkyçje e ka shkyçur konsumatorin e lartpërmendur nga rrjeti elektrik, sipas nenit 6.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë. Urdhëresa për shkyçje e ka ngarkuar kartelën e konsumatorit (borxhin e përgjithshëm) në shumë prej 100.00 € plus TVSH, pra e gjitha prej 115.00 €.
  - 5.4 Taksa për parapagimi për Radio Televizionin e Kosovës është i bazuar në Ligjin Nr. 02/L-47 për Radio Televizionin e Kosovës ku në dispozitat e ligjit ceket:
    - ✓ Në bazë të nenit 20.4 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike.
    - ✓ Sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të liruar nga obligimi i cekur me lartë, përfshihen banorët e vendbanimeve ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës ku mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçantë përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.
  - 5.5 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve i ZRRë-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRë-së, përgjigjen e KEK Sh.A dhënë konsumatorit, analizimin e dëshmimeve të paraqitura dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, konstaton se KEK Sh.A ka

zbatuar të gjitha procedurat e parapara si rregullin mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë si dhe Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës, andaj duke u bazuar në atë se çka u tha më sipër Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE refuzon ankesën e konsumatorit si të pabazë.

6. Më 14.01.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **ta refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 5 të këtij Vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Kryesuesi i Bordit të ZRrE-së**

---

**Anëtarët e Bordit:**

---

---

---

---